

V E N D I M
I GJYQTARES SE VETME

Sot me date 27.11.2000, une, gjyqtar i Gjykates se rrethit Tirane M. Mufali pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Petraq Mufali i biri i Jorgjit, lindur me 1968 ne fshatin Hajdaraj te rrethit te Elbasanit dhe banues ne Hajdaraj te rrethit te Elbasanit, i cili me kerkoi depozitimimin e Vendimit Nr.1 date 14.1.2000 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "MUFALI" sh.p.k.

K O N S T A T O V A

Se me Vendim te Gjykates se rrethit Tirane nr.17.083 date 27.11.1997 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregetare "Mufali" sh.p.k me dy ortakje Petraq Mufali dhe Andrea Shqau.Me Vendimin nr.1 date 14.1.2000 te asamblese se ortakjeve eshte vendosur:

1. Kuotat prej 50% ne sh.p.k "MUFALI" te ortakut Andrea Shqau ti shiten ortakut tjetër Petraq Mufali.
 2. Shoqeria "MUFALI" sh.p.k te mbetet me ortak te vetem dhe me administrator te vetem Petraq Mufali. Administrator i shoqerise mbetet Z.Petraq Mufali.
 3. Shoqeria "Mufali" sh.p.k do te ruaje emerimin themelues te saj Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar "Mufali" sh.p.k
 4. Ky vendim i bashkengjitet statutit te shoqerise "Mufali" sh.p.k te miratuar nga gjykata kopetente.
 5. Depozitimimin prane regjistrimit tregetar te ketij vendimi.
- Ne keto kushte ai kerkon depozitimimin e tyre prane regjistrimit tregetar. Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE

Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992"Per shoqerite tregetare"dhe atij nr.7667 date 28.01.1993"Per regjistrin tregetar".

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

Depozitimn ne regjistrin tregetar te Vendimit te Asamblese se Ortakeve nr.1 date 14.1.2000.

Te behen shenimet perkatese ne regjistrin tregetar.

Ndaj vendimit lejohet ankim.

GJYQTARE

Majlinda Dedi
Spasiv